Kronikë

Tiranë/ Do të kryenin atentate me eksploziv me telekomandë, arrestohet 20-vjeçari nga Shkodra, në kërkim i vëllai (EMRAT+VIDEO)

Dy mina me telekomandë me lëndë eksplozive C4 peshë 300 gram, janë sekuestruar nga policia e Tiranës, të cilat dyshohet se do të përdoreshin për ngjarje të rënda kriminale. Në pranga ka rënë Jesar Shabaj, dhe është shpallur në kërkim vëllai i tij Jasar Shabaj, të dy banues edhe në Shkodër e Tiranë

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

Sh.com Redaksia
19 Janar, 09:01 | **Përditësimi: 19 Janar, 09:27**

Share

TIRANË- Jesar Shabaj, 20 vjeç banues në Tiranë, por edhe në Shkodër në Postibë, është arrestuar nga blutë e kryeqytetit, pasi në bashkëpunim me vëllain e tij, Jasar Shabaj, 23 vjeç, i cili është shpallur në kërkim, kishin planifikuar që të kryenin atentate me eksploziv.

Policia thotë se në kuadër të operacionit 'Brothers' ka sekuestruar 2 mina me telekomandë me lëndë eksplozive C4 peshë 300 gram, të programuara për shpërthim në distancë (të pajisura me aparat celular dhe me kapsolla detonatore), të cilat dyshohet se do të përdoreshin për kryerjen e ngjarjeve të rënda kriminale.

Gjithashtu janë sekuestruar aparati celular i 20-vjeçarit të ndaluar si dhe një përforcues grushti (dorezë metalike).

Sh.com

LEXO EDHE:
Terminali lindor i autobusëve në funksion të plotë, Rama ndan pamjet: Shembull i kalimit të infrastrukturës së shërbimeve në një nivel tjetër

Në lidhje me ngjarjen po vijojnë hetimet, në drejtimin e Prokurorisë së Tiranës, për të dokumentuar implikimin e personave të tjerë, të përfshirë në këtë veprimtari kriminale.

M.Q./r.k./Shqiptarja.com

TAG: Tirane | jasar shabaj | jesar shabaj | mina me telekomandë | policia e tiranes

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
Presidenti dekreton ligjin për komisionet hetimore, si e vlerësoni?

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

Përplasja me Nokën e Bardhin në komision, Açka në Report Tv: E parapërgatitur, ishte një formë terrori! S'e kisha çuar nëpër mend të gjendesha në atë situatë

18 Janar, 19:23

Zgjedhjet 2025, Veliaj: Në Rrogozhinë treguam se nëse bëjmë punë të mira, njerëzit besojnë dhe rezultati është pozitiv

18 Janar, 15:18

Tentoi të vidhte në një lokal ditën e djeshme, arrestohet 40 vjeçari në Tiranë! Dyshohet si autor i 4 grabitjeve të tjera në kryeqytet

18 Janar, 15:09

E rëndë në Tiranë/ Arrestohet kardiokirurgu i Sanatoriumit, akuzohet se abuzoi seksualisht dhe shfrytëzoi 16 vjeçaren për 2 vite! E prezantonte si gruan e katërt (EMRI)

Sokol Dema

18 Janar, 14:32

Tirana ka dy vite pa fitore në Durrës, Julian Ahmataj: Kemi dy mungesa, nesër na duhen tri pikët

18 Janar, 13:20

Vrasja e Stiven Toshkesit pas sherrit për një vajzë, Prokuroria e Tiranës mbyll hetimet! Kërkon gjykimin e Axel Hoxhajt dhe Ensi Mazes

18 Janar, 12:41

Vodhën 5 mln lekë nga bankomatët në Tiranë, në kërkim 3 rumunët! Skema, përdoronin karta të klonuara (VIDEO + FOTO)

Sokol Dema

18 Janar, 08:59

Vorë/ E zuri gjumi në timon, 64-vjeçari humb kontrollin e makinës dhe bie në kanal, ndërron jetë në vend

18 Janar, 08:30

Tirana sociale, Muharemi: Nga 3500 familje, 423 prej tyre kanë nevojë për rikonstruksion total banese! Drejt përfundimit puna për 25 shtëpi

17 Janar, 22:33

Si mbijeton Belind Këlliçi i papunë? Fakte të rënda për pastrim parash gjatë fushatës për kryebashkiak

Sh.com Redaksia investigative

17 Janar, 19:57

Zyrtare/ Pjesë e Olympiacos dhe Nottingham, Egnatia prezanton ish-mbrojtësin e Kombëtares kuqezi

17 Janar, 15:59

Qytetari denoncon vjedhjen në Rinas: Më morën 9500 euro nga valixhja! Nisin hetimet! Mister ku humbën, në Tiranë apo Vjenë

Sokol Dema

17 Janar, 15:34

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje